



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 82, datë 29.06.2020**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROSPEKTIT TË SHOQËRISË “FONDI BESA” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 30, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, si dhe Rregullores nr. 16, datë 31.01.2018 “Për formularin e kërkesës, përmbajtjen e dokumentacionit për miratim prospekti për emetimin e obligacioneve”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e prospektit të shoqërisë “Fondi Besa” sh.a., për ofertën private të emetimit të obligacioneve afatgjatë me normë interesi fikse, për shumën 150,000,000 lekë.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR**  
**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin METE**